



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2018

**V E N D I M**

**Nr. 87, Datë 05.04.2018**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 39, datë 23.03.2018, e Z. E.Z., ku pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar” të nxënëses D. Y., nga ana e DAR Shkodër.

kodër.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

**K O N S T A T O I:**

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, si dhe referuar dokumentacionit bashkëlidhur saj, rezulton se ankuesi E. Z., është drejtor i Shkollës 9 vjeçare “At Gjon Karma”, Guri i Zi, Shkodër. Ankuesi parashton ankesën e tij, për nxënësen D. Y., e cila vuan nga autizmi, duke pretenduar se kjo nxënëse diskriminohet nga Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër, pasi shërbimi që jepet nga mësuesja ndihmëse, e caktuar për këtë nxënëse, nuk ofrohet në orarin e duhur, duke bërë që kjo ndihmë të mos jetë rezultative.